

ARISTOTEL SPIRO**MBI PARIMET E (DREJT)SHKRIMIT TË SHQIPES
STANDARDE**

Sot, 37 vjet pas Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, të flasësh mbi parimet e drejtshkrimit të saj, nuk mund veçse të nisesh nga kritere teorike gjuhësore dhe nga një perspektivë kohore, që bën të mundur kritikën e qëndrimeve, vlerësimeve dhe praktikave të zbatuara.

Ky diskutim, megjithëse kërkon t'i shmangët karakterit të mirëfilltë sociolinguistik, ka pashmangërisht referime të vazhdueshme të kësaj natyre, meqenëse tema historikisht mund të inkuadrohet në këtë fushë.

Është një fakt i pamohueshëm se Kongresi i Drejtshkrimit përbën ngjarjen kulmore të gjithë historisë së gjuhës shqipe. Ai kodifikoi gjuhën shqipe me një varg rregullash drejtshkrimore, të cilat u kombëtarizuan, d.m.th. u zbatuan me fuqinë e ligjit shtetëror, për arsye se shteti shqiptar e kishte shndërruar çështjen gjuhësore në pjesë të politikës së vet. Shkolla dhe media ndikuan fuqishëm në rrënjosjen dhe zbatimin e këtyre rregullave.

Kongresi i Drejtshkrimit (1972) zhvillohej 64 vjet pas Kongresit të Manastirit (1908), i cili, edhe pse miratoi dy alfabetë, praktikisht e njësoi shkrimin shqip¹. Gjuha shqipe kishte tashmë alfabetin e vet, ose më mirë shkrimin e njësuar. Flasim për parimet e drejtshkrimit, por praktikisht këtë term e përdorim në kuptimin e gjerë të parimeve të shkrimit. Në një kuptim të rreptë gjuhësor, kur bëjmë fjalë për parimet e drejtshkrimit, nënkuptojmë normën drejtshkrimore. “Drejtshkrimi, siç pohon F. Agalliu, duhet të merret me mënyrën e shkrimit të temave të fjalëve, të fjalëve në format e tyre të ndryshimit morfologjik, me drejtshkrimin e morfemave-rrënjëve, afikseve fjalëformuese dhe mbaresave”². Vijimisht fjala drejtshkrim do të përdoret, për hir të traditës, me kuptimin e

¹ A. Kostallari, *Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Gjuhësisë e Letërsisë, Tiranë, 1973:53.

² F. Agalliu, Rreth disa çështjeve të zbatimit të parimit morfologjik në drejtshkrimin e shqipes, *Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe*, 20-25 nëntor 1972, II, Tiranë, 1973:7

shkrimit, siç përdoret në të vërtetë në literaturën përkatëse në gjuhën shqipe.

Diskutimi mbi parimet e (drejt)shkrimit të një gjuhe nënkupton raportin e sistemit të saj grafematik me sistemin fonematik. Ky problem është i lidhur ngushtë edhe me alfabetin e gjuhës. Në bazë të natyrës së këtij raporti varet edhe parimi i (drejt)shkrimit të zbatuar.

Për arsye të kushteve historike, zgjidhja teorike e këtij problemi në gjuhën shqipe është tejkaluar shpesh nga imperativi i zgjidhjeve praktike. Kështu u veprua në rastin e alfabetit të shqipes, prandaj sot themi në mënyrë pleonastike se alfabeti shqip ka 36 shkronja. Dëshira për t'i dhënë shqipes një alfabet të thjeshtë, të kuptueshëm e të zbatueshëm për të gjithë shqiptarët, një alfabet ku çdo shkronje do t'i korrespondonte një tingull, krijoi mitin e një shkronje të përbërë prej dy grafemash (dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh) dhe mitin tjetër, sipas të cilit gjuha shqipe shkruhet ashtu siç shqiptohet. Duhet thënë se këtu kemi të bëjmë me disa të vërteta relative, të marra në një kuptim të gjerë. Shqyrtimi me kritere gjuhësore na çon përballë një miti të pavërtetë, i cili, për hir të së vërtetës shkencore, duhet rrëzuar.

Për t'u shprehur më qartë, fjala është për parimin themelor të drejtshkrimit të gjuhës shqipe, që në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe u formulua si *parimi fonetik*, një parim sipas të cilit fjalët shqiptohen “ashtu siç shkruhen”. Ishte ky një formulim që nuk kishte ndryshuar në debatin më se njëshekullor për këtë gjuhë, që nga koha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare e deri në fund të shek. XX³. Vetëm formalisht thuhet se “Thelbi i parimit fonetik në drejtshkrimin e shqipes, që mbështetet në një sistem grafik ku ka lidhje të drejtpërdrejtë midis shkronjës dhe tingullit-fonemë, është aspekti fonologjik”⁴.

Zgjidhjet që u dhanë në Kongresin e Drejtshkrimit (1972) përmbajnë ato kontradikta që rrjedhin nga të kuptuarit e gabuar të parimit themelor të drejtshkrimit. Edhe shpjegimi i “aspektit fonologjik”,

³ Shih M. Domi, “Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit (14-22 nëntor 1908)”, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit (14-22 nëntor 1908) - Studime, materiale, dokumente*. Universiteti i Tiranës - Instituti i Historisë - Instituti i Gjuhësisë e Letërsisë, Tiranë, 1972:22; T. Osmani, *Histori e alfabetit të gjuhës shqipe*, SHBLSH, 1987:140, 176.

⁴ *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Gjuhësisë e Letërsisë, Tiranë, 1973:7.

interpretuar nga A. Kostallari⁵ dhe mishëruar në po atë mënyrë në “Rregullat e Drejtshkrimit”, dëshmon për një pështjellim në të kuptuarit e termit “fonologjik”. Duket, pra, sikur termi “fonetik” është më përfshirës, ndërsa termi “fonologjik” sikur është thjesht një aspekt i tij⁶. Në të vërtetë, është e kundërta. Aspekti fonetik inkadrohet në aspektin fonologjik, i cili është më përfshirës. Shpjegimi për aspektin fonologjik banalizohet në “përdorimin social të tingujve të gjuhës në procesin e marrëdhënieve midis njerëzve”⁷.

Sipas nesh, parimi i zbatuar nuk mund të jetë fonetik, por fonologjik. (Drejt)shkrimi i çdo gjuhe të njësuar, që përdor shkrimin alfabetik, nuk mundet veçse të ngrihet mbi bazën e zbatimit të parimit fonologjik. Parë në këtë prizëm, (drejt)shkrimi ideal i një gjuhe është ai ku zbatohet plotësisht parimi fonologjik, d.m.th. çdo foneme i përkon një grafemë dhe çdo grafeme i përkon një fonemë. Por mund të pohohet, gjithashtu, se nuk ka kuptim të flitet për drejtshkrim jashtë parimit fonologjik. Ky parim vendoset në bazë të drejtshkrimit të çdo gjuhe. Mbi këtë parim mbështetet, p.sh., shkrimi i frëngjishtes⁸.

Për fat të keq, ky parim nuk u kuptua teorikisht siç duhet, prandaj dhe nuk u mor parasysh në Kongresin e Drejtshkrimit. Konfuzioni teorik u shtua edhe me formulimin e një atë ashtuquajtur “parim morfologjik” në drejtshkrimin e shqipes. Pasi u pa që parimi fonetik nuk mund të ishte i zbatueshëm në të gjitha rastet, parimi “morfologjik” erdhi për të “shpëtuar”, pra, për të plotësuar parimin e parë. Futja e një termi gramatikor në teorinë grafematike e pështjelloi më tej gjendjen. Nga njëra anë u pa që parimi fonetik nuk mund të kënaqte gjitha rastet e drejtshkrimit, por nga ana tjetër ai ruante autoritetin e emërimit, sepse parimisht çdo tingulli duhej t’i përkonte një shkronjë. Kështu, u pranuan raste ku brenda të njëjtit logogram (fjalë) ishin zbatuar dy parime drejtshkrimore të ndryshme (p.sh. në logogramet *zbardh*, *zhdredh*, *zgjedh* bashkëtingëlloret nistore shkruhen sipas parimit “fonetik”, ndërsa në bashkëtingëlloret fundore ky parim është i diskutueshëm).

⁵ A. Kostallari, po *aty*, 67-68.

⁶ Po *aty*, f. 67.

⁷ *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Gjuhësisë e Letërsisë, Tiranë, 1973:7.

⁸ C. Blanche-Beneviste & A. Chervel, *L’orthographe*, Maspero, Paris 1978:133.

Njohja e parimit fonetik si parim bazë i drejtshkrimit të shqipes u vu në dyshim qysh në Kongres. U theksua se “teoria e drejtshkrimit jo vetëm tek ne, por edhe në vende të tjera mbetet një nga fushat pak të përpunuara të gjuhësisë. Që këtej rrjedhin mjaft pasaktësi dhe kundërthënie, të cilave s’ka mundësi t’u shpëtojë as drejtshkrimi ynë”⁹. Duke tërhequr vëmendjen se “çështjet gramatikore duhen lënë jashtë rregullave të drejtshkrimit për t’u marrë me këtë punë morfologjia”¹⁰, u arrit në përfundimin se “drejtshkrimi i sotëm i shqipes, ashtu siç paraqitet në “Rregullat”, bazohet më tepër në parimin morfologjik dhe tradicional”¹¹. Kjo ide, megjithatë, nuk u mor parasysh në hartimin përfundimtar të rregullave të drejtshkrimit.

Diskutimi për parimet e drejtshkrimit të gjuhës shqipe vazhdoi edhe pas Kongresit. Vazhdon të ekzistojë përsëri një mospërputhje mendimesh në literaturën gjuhësore shqiptare. Një pjesë rikonfirmon se parimi themelor i sistemit shkrimor të shqipes është parimi fonetik¹². Argumenti kryesor për të mbështetur zbatimin e të ashtuquajturit “parim fonetik” është se “fjalët dhe pjesët e tyre të kuptimshme shkruhen ashtu siç shqiptohen”¹³ apo “fjalët dhe morfemat e tyre shkruhen ashtu siç shqiptohen në ligjërimin letrar”¹⁴. Lihet të nënkuptohet kësaj sikur ka gjuhë, të cilat nuk shkruhen ashtu siç shqiptohen (!). Pjesa tjetër e gjuhëtarëve vazhdon ta vërë në dyshim parimin fonetik ose të mbështetë se parimi kryesor i drejtshkrimit të shqipes nuk është ai fonetik. Në shtypin shkencor është shkruar lidhur me këtë se “kur zbatimi i veçuar i parimit fonetik do të çonte në errësimin ose në prishjen e strukturës morfologjike e fjalëformuese të fjalëve, në drejtshkrimin tonë zbatohet parimi morfologjik”¹⁵.

⁹ F. Agalliu, “Rreth disa çështjeve të zbatimit të parimit morfologjik në drejtshkrimin e shqipes”, *Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe 20-25 nëntor 1972*, II, Tiranë, 1973:7.

¹⁰ *Po aty*, f. 7.

¹¹ *Po aty*, f. 8.

¹² Shih, p.sh., A. Dodi, Rreth parimit themelor të drejtshkrimit të shqipes, *Gjuha jonë*, nr. 2, 1983:25-31.

¹³ A. Kostallari, *vep. e cit.*, 67.

¹⁴ A. Dodi, *art. i cit.*, *po aty*, f. 28. .

¹⁵ B. Beci, “Parimi morfologjik i drejtshkrimit të gjuhës shqipe”, *Gjuha jonë*, nr. 2, 1984:24.

Në përgjithësi vërehet, siç thamë edhe më lart, një pështjellim në përdorimin e terminologjisë. Kongresit të Drejtshkrimit nuk i parapriu ndonjë diskutim në *planin teorik* për çështje të shkrimit e të drejtshkrimit. Bibliografia në gjuhën shqipe për këtë çështje është shumë e varfër. Studimet fonetike kishin ndjekur një model tradicional dhe studimet fonologjike ishin praktikisht të panjohura. Përkundrazi, studimet në fushën morfologjike kishin njohur arritje më të mëdha. Prandaj, aty ku fonetika nuk mundej të shpjegonte dukuri të (drejt)shkrimit, ndërhynte morfologjia. Parimi morfologjik vinte për të plotësuar zbrazëtitë e parimit fonetik.

Në të vërtetë, gjetja e parimit morfologjik ishte një zgjidhje kompromisi. E themi këtë se, kur flitet për (drejt)shkrimin e një gjuhe, kemi parasysh në radhë të parë raportin që ekziston midis formës së folur dhe formës së shkruar të ligjëritimit. Asnjë drejtshkrim i asnjë gjuhe që mbështetet në shkrimin alfabetik, nuk kërkon që çdo tingull të përkojë medoemos me një shkronjë. Ky do të ishte parimi fonetik. Shkrimi alfabetik, i krahasuar me shkrimin piktografik, ideografik, silabik, është shumë më praktik në përdorim. Por brenda kuadrit të këtij shkrimi, zbatimi i parimit fonetik, është prapëseprapë joekonomik, sepse do të kërkonte një numër më të madh shkronjash për të pasqyruar “tingujt”. Për të folur me një terminologji më të rreptë gjuhësore, parimin fonetik do ta përkufizonim si parim sipas të cilit *çdo realizim fonetik i një foneme, çdo allofon, do të kishte një grafemë të veçantë* dhe, anasjelltas, çdo grafeme do t'i përkonte një realizim fonetik i veçantë, një alofon. Alfabeti Fonetik Ndërkombëtar (I. P. A.), p.sh., është një sistem i tillë shkrimor.

Parimi themelor, sipas të cilit do të interpretoheshin logogramet e shqipes, është parimi fonologjik. Sipas këtij parimi, *çdo grafeme a kombinimi grafemash* (dhe jo çdo realizimi fonetik) *i përkon një fonemë*. Nuk janë tingujt që u korrespondojnë shkronjave, por fonemat që u korrespondojnë grafemave¹⁶. Dallimi midis grafemës dhe shkronjës është i njëjtë me dallimin midis fonemës dhe tingullit¹⁷. Për (drejt)shkrimin e një gjuhe ka rëndësi raporti që krijojnë grafemat e gjuhës me sistemin e saj fonetik/fonologjik. Drejtshkrimi ideal është ai në të cilin ka një

¹⁶ G. Augst, “Descriptively and explanatory adequate Models of Orthography”, *New Trends in Graphematics and Orthography* (Ed. G. Augst), Walter de Gruyter, Berlin – New York 1986:27.

¹⁷ C. Blanche-Beneviste & A. Chervel, *vep. e cit.*, 119.

bashkëpërkim dykahësh (me terma matematikë, korrelacion biunivok) midis grafemave dhe fonemave¹⁸. Një shembull të qartë përbën këtu sistemi shkrimor i bullgarishtes, në të cilën bashkëpërkimi dykahësh zbatohet plotësisht.

Siç nënvizuar edhe më lart, përparësia e parimit fonetik në drejtshkrimin e shqipes u vu në dyshim që në Kongresin e Drejtshkrimit. Sipas F. Agalliut, parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes nuk është parimi fonetik, por ai morfologjik. Rregullat e drejtshkrimit bazohen më tepër në parimin morfologjik dhe tradicional¹⁹. Ai mundohet të sqarojë se çfarë kupton me parim morfologjik, kur shpjegon se “drejtshkrimi duhet të merret me mënyrën e shkrimit të temave të fjalëve, të fjalëve në format e tyre të ndryshimit morfologjik, me drejtshkrimin e morfemave, rrënjëve, afikseve fjalëformuese dhe mbaresave”²⁰. Si rast tipik ai sjell drejtshkrimin e *ë*-së së patheksuar në trup të fjalës në disa kompozita dhe formime prapashtesore, që mbështetet, sipas tij, në parimin morfologjik, të cilin e shpjegon si ruajtje të përbërjes fonematike të temës së fjalës së parë (bukëpjekës, udhëheqës, mirëmbajtje, anëtar, punëtor etj.). Lind pyetja: Si mund të quhet morfologjik një parim që mbështetet në ruajtjen përbërjes fonematike? Rastet që sillen si shembuj lidhen vërtet me çështje morfologjike, por janë dukuri morfonologjike. Ato kanë të bëjnë jo me raportin shkrim-gramatikë (apo shkrim-morfologji), por me raportin shkrim-shqiptim. Problemi i vërtetë drejtshkrimor është ky: Grafema do të jetë shënjuese e vlerës fonetike apo e vlerës fonologjike të realizimit fonetik? Nëse e marrim si shënjuese të vlerës fonologjike, atëherë do të do të zbatojmë një sistem adekuat shkrimor, ku rastet e varianteve fonetike, do të paraqiten në të shkruar me një grafemë të vetme dhe jo me grafema të veçanta. Në këtë mënyrë shkrimi nuk bëhet pengesë në të kuptuarit e strukturës fonologjike të gjuhës, por e lehtëson atë. Po ashtu, nuk errësohen raportet e strukturës morfologjike, për shkak të ndryshimeve morfologjike që ndodhin. Fakti që shkrimi “fonematik” ndihmon në ruajtjen e imazhit shënjuës të morfemave nuk do të thotë se zbatohet ndonjë parim morfologjik. Morfologjia në këtë rast është një fushë, e cila përfiton nga veprimi i (drejt)shkrimit të mbështetur mbi parimin fonologjik. Por ky fakt nuk mund të jetë argument për t’i atribuar

¹⁸ C. Blanche-Beneviste & A. Chervel, *vep. e cit.*, 135.

¹⁹ F. Agalliu, *art. i cit.*, po aty, 11.

²⁰ F. Agalliu, *art. i cit.*, po aty, 7.

drejtshkrimit një parim morfologjik. Çka është njohur deri tani si parim morfologjik, nuk është tjetër veçse *parimi fonologjik*. Në këtë dritë duhet parë edhe (drejt)shkrimi i shqipes. Njohja e parimit fonologjik si parim bazë i (drejt)shkrimit të gjuhës shqipe do të ndihmojë në interpretimin e saktë dhe të qartë të sistemit të saj shkrimor, do të ndriçojë më qartë marrëdhëniet midis sistemit grafematik dhe fonologjik të saj. Analiza fonetike dhe fonologjike që zbatohet gjerësisht nëpër shkolla mbështetet kryesisht në tekste të shkruara. Nëse kihet parasysh çfarë fshihet pas grafemave, atëherë mund të nxirren përfundime të sakta për sistemin fonetik/fonologjik të gjuhës. Gjithashtu, duke marrë për bazë parimin fonologjik, do të gjykohen ato raste kur, për arsye të ndryshme zbatohet i ashtuquajtimi “parim fonetik”, që nga këndvështrimi i sotëm mund të interpretohet si parim tradicional. Këtu hyjnë sidomos emrat e përveçëm (njerëzish ose vendesh). P.sh. emrat *Bjellorusi, Çabej, Evropë, Hesiku, Kili, Moxart, Nausika*²¹ etj. shkruhen ashtu, sepse në këtë trajtë përdoren tradicionalisht.

Një çështje me interes do të ishte në këtë pikë diskutimi për modifikime apo ndryshime në drejtshkrim. Mendimi ynë është se ndërhyrje në rregullat e drejtshkrimit nuk duhen bërë, ose duhen bërë në raste të veçanta dhe shumë rrallë. Shumë logograme të vendosura në Kongresin e Drejtshkrimit zbatojnë të ashtuquajturin *parim fonetik*, i cili bie ndesh me parimin fonologjik. Rasti i bashkëtingëlloreve nistore *sh/zh* është kuptimplotë (*shfajësoj, shfaq, shfaros, shfryj, shlyej, shndërroj, shthur, zhbllokoj, zhgënjim, zhvendos, zhvesh*²² etj.). Sipas parimit fonologjik, fjalët e sjella si shembull do të shkruheshin të gjitha me *ç* (siç shkruhen p.sh. logogramet *çdo, çfarë, çka* dhe derivatet e tyre²³). Sot këto logograme janë ngulitur thellë në ndërgjegjen e folësve e të shkruesve të shqipes dhe ideografikisht nuk mund të perceptohen ndryshe. Çdo ndërhyrje në të do të prishte imazhin e tyre shenjor. Fjala e shkruar perceptohet në trurin e folësve si një e tërë, si një figurë, apo ideogramë. Çdo ndryshim që ndodh në të reflektohet me prishjen e lidhjeve midis imazhit grafik dhe konceptit. Për hir të traditës, këto grafi do të ruhen ashtu siç janë. Në shkollat dhe fakultetet e gjuhës shqipe *praktikumi*, që

²¹ *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1973:90-105

²² Po aty, 72-73.

²³ Po aty, 73.

përfshin kryesisht rregullat e drejtshkrimit, duhet pasuruar me teorinë grafematike.

Si përfundim, mund të themi se parimi i drejtshkrimit të shqipes, ashtu si drejtshkrimi i çdo gjuhe që përdor shkrimin alfabetik, është *parimi fonologjik*.

SUMMARY

ON THE PRINCIPLES OF THE ORTHOGRAPHY OF STANDARD ALBANIAN

It is indisputable that the Congress of the Albanian Orthography represents a culmination in the history of Albanian language. It introduced a set of codified orthographic rules, which turned nationwide, i. e. they were implemented with the authority of the legislation, since the Albanian State had rendered the linguistic question a part of its policy. The education system and the media impacted the application of these rules.

The Congress of the Albanian Orthography (1972) put forth the orthographic principles. Due to historical reasons, the theoretical solutions of this question in Albanian have been surpassed by the imperative needs of the practical solutions.

The fundamental principle of the Albanian Orthography was formulated as *phonetic*, according to which words are pronounced “as they are written”. It is a tradition formulation that goes back in the period of the Albanian Renaissance.

The resolution of the Congress of the Albanian Orthography (1972) contains those contradictions which derive from the erroneous interpretation of the fundamental principle of the Orthography.

In my opinion, the implemented principle is not phonetic, but phonological. The Orthography of each standardized language, which uses the alphabetic writing system, can be established on the grounds of the phonological principle. It makes no sense talking about orthography by excluding the phonological principle. This constitutes the fundamental principle of every alphabetical writing system.

This principle was not taken into consideration in the Congress of the Albanian Orthography. Besides, a theoretical confusion was amplified by introducing in the Albanian orthography the so-called “morphological principle”. The introduction of a grammatical term in graphematic theory led the situation in confusion.

The dispute about the orthographic principles of the Albanian continued even after this Congress. The adoption of the morphological principle was in fact a compromise solution.

The fundamental principle, which the Albanian logograms are based, can be interpreted as phonological. According to it, *each grapheme or grapheme combination* (and not each phonetic realization) *corresponds to one phoneme*.

The so-called morphological principle is not but the phonological one. By recognizing the phonological principle as fundamental in the Albanian orthography this will help to define properly and clearly its writing system, it will shed light to the relations between its graphematic and phonological systems.

